

## **Konferenca e pare mbi Etiken Mjekesore me titull "Respektimi i Etikes Mjekesore dhe Pergjegjesia Profesionale e Bluzave te Bardha"**

Sot me date 8 Qershor 2016 ne Hotel Tirana International, Urdhri i Mjekeve te Shqiperise organizoi Konferencen e pare mbi Etiken Mjekesore me titull "Respektimi i Etikes Mjekesore dhe Pergjegjesia Profesionale e Bluzave te Bardha". Kjo Konference u zhvillua ne nje bashkepunim me Urdhrat e tjere profesionale (Urdhri i Stomatologut, Infermierit dhe Farmacisteve), si dhe me nje mbeshtetje nga Spitali privat "SALUS".

Me poshte do te gjeni fjalen pershendetese te Dr. Fatmir Brahimaj mbajtur ne kete Konference:

Fjala Përshëndetëse

DR.FATMIR BRAHIMAJ

President i UMSH-së

Të nderuar Zonja dhe Zoterinj,

Sot UMSH-ja si nismëtar i një veprimtarie mjaft të rëndësishme ju uron mirëseardhjen dhe ju falenderon për praninë tuaj, në këtë tubim për të diskutuar dhe ndarë mendime, përvoja e sygjërime por edhe detyrime dhe përgjegjësinë profesionale për një temë thelbësore të profesionit tonë sic është Etika mjekësore.

Qysh prej Hipokratit ajo është konsideruar pjesë integrale e mjekësisë, komponent i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm si në edukimin bazë dhe në kurrikulat universitare ashtu edhe në EVM-në gjatë gjithë jetës. Mjeku duhet të shoh gjithmonë sjelljet e tij etike dhe të përditësojë rregullisht njohuritë e tij në këtë fushë, ahtu sic bënë edhe për dijet dhe aftësitë tekniko-shkencore. Sëmundja s'mund të krahasohet me një difekt në makinë dhe mjeku s'është një mekanik që duhet ta rregullojë atë. Për të kryer saktë detyrën e tij me një performancë të lartë profesionale, mjeku duhet të njohë dhe të përvetësojë edhe artin e sjelljes dhe të komunikimit me të sëmurin.

Përvetësimi, aplikimi dhe kombinim e tyre me aftësitë tekniko-shkencore e praktikën mjekësore, përbën bazën e sekretit në punën e mjekut. Ato janë parimet thelbësore të cdo kodi të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, që është busulla apo bibla e cdo bashkësie mjekësore në të gjithë botën, duke sqaruar raportet e profesionalizmit mjekësor të drejtat e njeriut dhe ligjin. Pra etika mjekësore është gjithashtu e rëndësishme edhe në ndërveprimet me shoqërinë, koleget, për të udhëhequr hulumtimet mjekësore e për të marrë pozicionin e duhur ndaj fenomeneve të reja me interes mjekësor dhe social.

Parimet etike si respekti për njerëzit (nga postura e mjekut deri tek veprimet dhe fjala e tij), pëlqimi pas informimit paraprak dhe mirëbësimi janë bazë e marrëdhënies mjek-pacient. Këto marrëdhënie përbëjnë thelbin e etikës mjekësore dhe besimi reciprok është themeli i këtyre marrëdhënieve. Ja pse respektimi EM shihet nga ne si element i rëndësishëm edhe për daljen nga kriza e besimit të publikut ndaj bluzave të bardha.

Komunikimi jo i mirë mjek pacient qëndron në bazën e shumicës së ankesave të drejtuara nga pacientët dhe publiku pranë UMSH-së. Sqarimi dhe komunikimi i mirë ka bërë që shpesh këto të zgjidhen me anën e pajtimit qysh në seancën e parë ballafaqese.

Por më lejoni të ndalem edhe në një fakt tjetër të rëndësishëm. Ne kërkojmë me domosdoshmëri respektimin e EM si përgjegjësi profesionale të mjekut. Por ana tjetër e medaljes është edhe vlerësimi i figurës së mjekut, rolit të tij të pazvendesueshëm në sistemin shëndetësor, ndërgjegjes, përkushtimit ,pasionit, humanizmit e sakrificës së tij. Kjo sigurisht nëpërmjet një edukate të lartë qytetare, etike të përgjithshme humane nga cdo individ dhe mbarë shoqëria. Natyrisht përvoja dhe tradita nuk mungon, po ashtu edhe përpjekjet e gjithanshme nga personeli, pacientët dhe shoqëria.

Megjithatë akoma përdorimi i këtyre parimeve në praktikë në situata specifike shpesh është problematik, pasi mjekët, pacientët, anëtarët e familjeve të tyre dhe personeli tjetër në mbrojtjen shëndetësore, mund të mos pajtohen lidhur me atë se cila është mënyra më e mirë për të vepruar në ndonjë situatë të caktuar. Por theksoj se mësimi i etikës ka rëndësi dhe për të dalluar këto situata të rënda dhe për tu ballafaquar me to në mënyrë racionale dhe parimore.

Etika mjekësore është gjithashtu e lidhur ngushtësisht me ligjin. Në shumë vende ka ligje të cilat përcaktojnë se si mjekët duhet të ballafaqohen me çështje etike në përkujdesjen e pacientit dhe në hulumtimet. Por EM dhe ligji s'janë identike shumë shpesh , etika cakton standarte më të larta sjelljeje se ligji. Ndonjëherë etika kërkon që mjekët të mos i përmbahen ligjit, i cili kërkon sjellje jo etike.

Pra panvarësisht se gjithcka ndryshon (edhe shkenca mjekësore, edhe sistemi shëndetësor që reformohet edhe shoqëria që ndëron sistemi, hera herës edhe me tranzicion të vështire) për vetë objektin, domosdoshmërinë dhe rëndësinë që ka etika mjekësore mbetet busull sepse në këtë dinamikë ligjesh e prurjesh kontekstesh te reja, ajo na mëson si të pozicionohemi, të fitojmë, të meritojmë dhe të risim, atë që është e rëndësishme për mjekun dhe cdo profesionisti të shëndetësisë: besimin dhe respektin e të sëmurve dhe të gjithë shoqërisë e më tej të realizojmë një kujdes cilësor për pacientët duke siguruar shëndetin e cdo individi dhe gjithë shoqërisë.

Në këtë kontekst urdhrat profesional në shëndetësi kanë detyrimin moral, profesional dhe ligjor të kujdesen në zbatimin, konsolidimin, respektimin e kodeve etike si dhe monitorimin dhe parandalimin e shkeljen të tyre në praktikën mjekësore. Referimet e diskutimet e sotme me sygjerimet e konkluzionet e arritura mendoj se do të japin kontributin dhe ndihmën e tyre drejt arritjes së objektivave të dëshiruara. Ju falenderoj edhe njëherë për praninë dhe i uroj sukses punimeve të konferencës.

Ju faleminderit për vemendjen.

